




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. D-p. 2-D/DPK	Nr. Prot. 01-3777/15
Nr. Prot. 02	Prot. No. 30.10.2015
Nr. folio	Data
Nr. pages	02



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.10.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2783/15, për zyrtarin e lartë z. Haxhi Ibishi, Këshilltar në Kuvendin Komunal të Klinës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka hequr dore nga pozita e personit të autorizuar ne biznesin privat.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-2783/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Haxhi Ibishi, Këshilltar në Kuvendin Komunal të Klinës.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, z. Haxhi Ibishi, Këshilltar në Kuvendin Komunal të Klinës, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë, është identifikuar se ushtron veprimtari private si person i autorizuar, ne biznesin privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin te funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 21.09.2015, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Haxhi Ibishi, ka ardhur ne zyrat e AKK-së ku nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar për situatën në të cilën gjendet,

Zyrtari i lartë z. Haxhi Ibishi, është pajtuar me gjendjen dhe faktet, por është arsyetuar se nuk ka qen ne dijeni se kjo situatë është e ndaluar me ligjin ne fuqi, por është zotuar se brenda afatit ligjore do te bej ndryshimin e kërkuar nga AKK-ë, dhe do të largohet nga pozita e personit të autorizuar ne këtë biznes .

Me datën 22.10.2015, kemi pranuar dokumentin zyrtar nga ARBK-ja, ku dëshmohej se Haxhi Ibishi, nuk figuron me si person i autorizuar ne biznesin “O.S.I “Drilon-Med” me nr.70292062

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z. Haxhi Ibishi, Këshilltar në Kuvendin Komunal të Klinës, duke bërë ndryshimet sipas kërkesës së AKK-së, ne biznesin ku ka vepruar si person i autorizuar, dhe pasi janë krijuar rrethana të reja konsiderojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Haxhi Ibishi, Këshilltar në Kuvendin Komunal të Klinës, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

